

REPUBLIKA E SHIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË **“SIPËRMARRJE DHE MENAXHIM** **I BIZNESIT TË VOGËL ”**

Kodi: SMBV-20

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË VECANTË

“SIPËRMARRJE DHE MENAXHIM I BIZNESIT TË VOGËL”

(Kodi: SMBV-20)

I. Profili Profesional i Sipërmarrësit dhe menaxherit të biznesit të vogël.

a) Karakteristikat e Sipërmarrësit dhe menaxherit të biznesit të vogël.

Ky program u krijua që t'i jap ide të reja kursantit mbi konceptet dhe aspektet e rëndësishme të sipërmarrjes dhe menaxhimit të biznesit të vogël.

Përmes këtij kursi, kursanti do të njohë më mirë natyrën e sipërmarrjes dhe të drejtimit të bizneseve të vogla, si dhe do të pajiset me konceptet bazë ekonomike, konceptet bazë të menaxhimit, të hartimit të planit të biznesit, të përgatitjes së planit të marketingut, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të kryerjes së veprimeve financiare, si dhe me praktikatat më të mira të menaxhimit të cilësisë, teknologjinë e bazuar në kompjuter, si dhe rëndësinë e komunikimit, etj..

Ky program do të orientojë dhe aftësojë kursantët në fushën e krijimit dhe organizimit të një biznesi të vogël, duke ju dhënë atyre mundësi të jenë të aftë, konkures, novator dhe të suksesshëm në treg.

Suksesi i sipërmarrësit dhe menaxherit të biznesit të vogël është i lidhur ngushtë dhe me sjellje dhe qendrimet personale si: gadishmëria dhe përgjegjshmëria për të punuar, kujdesi dhe garantimi i sigurisë së cilësisë së shërbimit/produktit, respektimi i kulturës së biznesit, korrektësia, guximi dhe këmbëngulja, respektimi i mjedisit dhe kushteve të punës, etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e sipërmarrësit dhe menaxherit të biznesit të vogël.

Programi është në funksion të gjithë atyre punëkërkuessve të papunë, emigrant të riatdhesuar apo dhe të interesuar të tjerë, të cilët dëshirojnë të hapin bizneset e tyre të vogla, apo të punësohen pranë bizneseve të vogla ekzistuese në rolin e menaxherit.

Përfundimi me sukses i këtij kursi i jep mundësi kursantit të kalojë ose të zhvillohet në profesione të tjera që kanë të bëjnë me fushën e ekonomisë dhe biznesit.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël”.

Në përfundim të Kursit, kursantët do të jenë të aftë të:

- zbatojnë etikën profesionale të sipërmarrësit dhe menaxherit të biznesit të vogël;
- shpjegojnë konceptet ekonomike;
- identifikojnë ide dhe mundësi për biznes real në Shqipëri;
- klasifikojnë format e sipërmarrjeve dhe profilet e sipërmarrësve;
- shpjegojnë procedurat ligjore dhe administrative për hapjen e biznesit të vogël në Shqipëri;
- shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit;
- menaxhojnë burimet njerëzore të biznesit të vogël;
- përgatisin planin marketing të biznesit të vogël;
- kryejnë veprime financiare të biznesit të vogël;
- ndërtojnë një plan biznesi.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël”.

Rekomandohet që pjesëmarrësit në Kursin “Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël”, duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë mbaruar arsimin e mesëm.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël”.

250 orë mësimore

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në sipërmarrje dhe menaxhim të biznesit të vogël.	SMBV-01-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të sipërmarrjes dhe menaxhimit të biznesit të vogël. 2. Kursanti përshkruan zhvillimin ekonomik të biznesit të vogël në Shqipëri. 3. Kursanti shpjegon konceptet ekonomike.
2	Sipërmarrja e biznesit të vogël.	SMBV -02-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti klasifikon format e sipërmarrjeve. 2. Kursanti përshkruan profilet e sipërmarrësit. 3. Kursanti shpjegon procedurat ligjore dhe administrative për hapjen e një biznesi të vogël në Shqipëri.
3	Menaxhimi i biznesit të vogël.	SMBV -03-20	120 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan funksionet dhe teknikat e menaxhimit. 2. Kursanti përgatit planin marketing të biznesit të vogël. 3. Kursanti menaxhon burimet njerëzore të biznesit të vogël. 4. Kursanti kryen veprime financiare të biznesit të vogël.
4	Ndërtimi i një plan biznesi.	SMBV -04-20	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan rëndësinë dhe përdorimin e plan biznesit. 2. Kursanti ndërton planin e biznesit.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e kursit për të gjitha rezultatet mësimore që përmbajnë të gjitha modulet e kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në provimin përfundimtar

teoriko-praktik. Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël”:

1.Moduli “Hyrje në sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të Vogël”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË SIPËRMARRJE DHE MENAXHIM TË BIZNESIT TË VOGËL.	SMBV-01-20
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me veçoritë e profilit të sipërmarrjes dhe menaxhimit të biznesit të vogël, me konceptet ekonomike, si dhe me veçoritë e zhvillimit të biznesit të vogël në Shqipëri.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori, 10% praktikë, 10% Vlerësim	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimimin e mesëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	<p>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e sipërmarrjes dhe menaxhimit të biznesit të vogël.</p> <p>Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë veçoritë e bizneseve të vogla në fushën ekonomike; - të përshkruajë prirjet e zhvillimit të veprimtarisë së biznesit të vogël; - të përshkruajë forma të ndryshme të sipërmarrjes dhe veçoritë e tyre; - të interpretojë vizionin e sipërmarrësit dhe krijimin e vizionit për biznesin; - të përshkruajë proceset e punës në një biznes të vogël dhe veçoritë e tyre; - të shpjegojë rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e sipërmarrësit dhe menaxherit të biznesit të vogël; - të shpjegojë avantazhet dhe disavantazhet e zotërimit të një biznesi të vogël; - të përshkruajë faktorët që ndikojnë në biznes dhe mundësitë e ndryshimit të këtyre faktorëve; - të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të sipërmarrësit dhe menaxherit të biznesit të vogël; - të përshkruajë dallimin midis sipërmarrësit dhe menaxherit të biznesit të vogël. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me gojë 	

-
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti përshkruan zhvillimin ekonomik të biznesit të vogël në Shqipëri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë sistemet ekonomike që ka përjetuar Shqipëria ndër vite;
- të përshkruajë sistemin ekonomik në ditët e sotme në Shqipëri.
- të përshkruajë pasojat që kanë sjellë ndryshimet ekonomike të Shqipërisë në shoqëri;
- të përshkruajë mjedisin e biznesit shqiptar;
- të shpjegojë ndikimin dhe rëndësinë e biznesit të vogël në ekonominë e tregut shqiptar;
- të përshkruajë resurset që ofron Shqipëria për biznes;
- të përshkruajë avantazhet dhe disavantazhet e një biznesi të vogël në Shqipëri;
- të analizojë faktorët e suksesit dhe të dështimit të një biznesi të vogël në Shqipëri (me anë të rastit studimor);
- të analizojë pengesat për zhvillimin e biznesit në Shqipëri (me anë të rastit studimor);
- të përshkruajë mundësitë për rritjen e biznesit të vogël në vend (me anë të rastit studimor).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 3 Kursanti shpjegon konceptet ekonomike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë çfarë është ekonomia;
- të përshkruajë faktorët nxitës dhe frenues që ndikojnë në ekonomi;
- të përkufizojë termin “biznes”, format dhe veçoritë e tyre;
- të shpjegojë termin “sipërmarrje”;
- të shpjegojë termin “menaxhim” dhe veçoritë e tij;
- të shpjegojë tre termat e funksioneve menaxheriale;
- të shpjegojë konceptet që lidhen me objektivat e një biznesi;
- të shpjegojë konceptet “mikroekonomi\makroekonomi”, të bëjë dallimin ndërmjet tyre.
- të shpjegojë konceptet që identifikojnë kërkesën dhe faktorët që e kushtëzojnë për të mira materiale;
- të shpjegojë termin “kërkesë\ofertë”
- të përkufizojë “koston” dhe “koston oportune”;
- të përkufizojë “konsumin”;
- të shpjegojë termat që përkufizojnë rritjen ekonomike, “investimet dhe kapitalin”;
- të shpjegojë termat “norma e interesit”;
- të shpjegojë termat për klasifikimin e biznesit sipas formës ligjore;

- të argumentojë rëndësinë e komunikimit në biznes;
- të shpjegojë mundësitë e rritjes së biznesit të vogël.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e klasës.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore, që i përgjigjet çdo moduli apo temë mësimore.
- Kursantët duhet të angazhohen në detyra konkrete në mjediset e klasës. Atyre duhet ti jepen detyra të ndryshme në lidhje me çështjet që trajtohen në modul si: në analizën e bizneseve konkrete në Shqipëri dhe në botë, në studimet e rasteve të bizneseve të sukseshme dhe të dështuar, në analizën e nevojës të tregut shqiptar për biznes. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. Rekomandohet që të zhvillohen vizita në biznese të vogla dhe të mëdha, për të analizuar ndryshimet, ngjashmëritë, avantazhet dhe disavantazhet.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Broshura, materiale të shkruara, rregullore etj.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj) për konkretizimin e njohurive dhe aftësive.
 - Vizita në bizneset e vogla dhe të mëdha shqiptare, kryesisht në rajonin përkatës.

2.Moduli “Sipërmarrja e biznesit të vogël”

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SIPËRMARRJA E BIZNESIT TË VOGËL.	SMBV-02-20
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko–praktik që i njeh kursantët me format kryesore të sipërmarrjes dhe profilet e sipërmarrësit, me avantazhet dhe disavantazhet e secilës formë dhe lloji, si dhe i aftëson në zbatimin e procedurave ligjore dhe administrative për hapjen e një biznesi të vogël në vend.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime	

Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimimin e mesëm. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në sipërmarrje dhe menaxhim të biznesit të vogël”
--	--

Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.

RM 1 Kursanti klasifikon format e sipërmarrjeve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë sipërmarrjen si biznes ekonomik;
- të bëjë dallimin e sipërmarrjeve si biznes social\inkubator\privat;
- të bëjë dallimin nga sipërmarrja e lirë dhe ajo e komanduar;
- të përshkruajë çfarë është sipërmarrja miks;
- të klasifikojë format e organizimit të sipërmarrjes;
- të shpjegojë format e pronësisë të sipërmarrjes;
- të vlerësojë formën e pronësisë individuale;
- të përshkruajë formën e bashkëpronësisë apo ortakërisë;
- të përshkruajë formën e organizimit të korporatave;
- të vlerësojë avantazhet dhe disavantazhet e secilës formë;
- të përcaktojë elementët kryesore që përcaktojnë formën juridike të sipërmarrjes;
- të shpjegojë sipërmarrjen me përgjegjësi të pakufizuar;
- të shpjegojë sipërmarrjen me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k);
- të interpretojë kriteret që klasifikojnë sipërmarrjet e mëdha dhe të vogla (Biznes i Vogel) dhe biznesi VIP;
- të përcaktojë kriteret mbi të cilat bëhet klasifikimi i sipërmarrjeve në Shqipëri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti përshkruan profilet e sipërmarrësve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë kuptimin e sipërmarrësit dhe funksionet e tij;
- të përshkruajë profilet kryesore të sipërmarrësve;
- të përshkruajë sipërmarrësin si menaxher;
- të dallojnë ndryshimet midis sipërmarrësit dhe menaxherit;
- të përshkruajë aspekte themelore të sipërmarrësit dhe aftësisë së tij;
- të listojnë karakteristikat e një sipërmarrësi të sukseshëm;
- të përcaktojë rolin e gruas sipërmarrëse, avantazhet dhe disavantazhet që ka një grua sipërmarrëse;
- të vlerësojë ndikimet e rolit gjinor në suksesin e një sipërmarrje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 3 Kursanti shpjegon procedurat ligjore dhe administrative për hapjen e biznesit të vogël në Shqipëri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë legjislacionin në fuqi në biznes;
- të përshkruajë paketën fiskale që aprovon qeveria çdo vit me të gjitha ndryshimet e herë pas hershme;
- të përshkruajë nene të caktuara të Kodit të Punës, me detyrimet dhe të drejtat e punëdhënësit dhe punëmarrësit, me kushtet e punës, me pushimet, masat disiplinore, dhe dokumentet që hartohen (kontrata e punës, elementet e saj) etj;
- të shpjegojë mënyrën e regjistrimit në QKB, në aplikacionet dhe platforma online;
- të shpjegojë procedurën e marrjes së NUIS (numri i identifikimit unik);
- të shpjegojë dhe të zbatojë të gjitha përgjegjësitë tatimore që rrjedhin pas regjistrimit;
- të shpjegojë procedurat për deklaratimet online të të gjitha detyrimeve;
- të argumentojë rëndësinë e zbatimit të të gjithë afateve tatimore të përcaktuara në ligj;
- të shpjegojë të gjitha penalitetet që rrjedhin nga mos pagimi në afatet e caktuara në ligj;
- të përshkruajë kategoritë e punësimit;
- të shpjegojë procedurën për tërheqjen kodit elektronik të taksave;
- të dallojë llojet e detyrimeve tatimore sipas strukturës së biznesit (biznesi i madh, i mesëm, i vogël);
- të dallojë detyrimet për tatimet kombëtare dhe ato vendore, me afatet e pagesës së tyre si dhe mënyrat e pagesës;
- të shpjegojë regjistrimin në administratën tatimore.
- të regjistrohet dhe të ketë kodin në administratën e sigurimeve shoqërore;
- të regjistrohet dhe të sigurojë librezën në administratën e sigurimeve shëndetësore;
- të regjistrohet në Inspektoriatin e Punës;
- të shpjegojë kushtet dhe kërkesat që duhen zbatuar në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e klasës dhe sipas mundësisë dhe në biznese /sipërmarrje të vogla.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e klasës.
- Atyre duhet ti jepen detyra të ndryshme në lidhje me çështjet që trajtohen në modul, dhe me anë të rasteve studimore të sjellin modele të sukseshme të sipërmarrjeve dhe

sipërmarrësve të Shqipërisë dhe të mbarë botës. Ata duhet të angazhohen në detyra konkrete për kryerjen e procedurave ligjore dhe administrative për hapjen e një biznesi të vogël në Shqipëri.

- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të kryhen vizita dhe praktika mësimore pranë bizneseve dhe institucioneve. Gjithashtu, për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Libra, broshura, fletëpalosje, katalogë, video projektor.
- Materiale nga interneti si dhe modele nga bota e biznesit.
- Medie didaktike (CD, filma, etj) për konkretizimin e njohurive dhe aftësive.

3. Moduli “Menaxhim i biznesit të vogël”

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MENAXHIM I BIZNESIT TË VOGËL.	SMBV -03-20
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko- praktik që i njeh kursantët me konceptet bazë të menaxhimit, funksionet kryesore të menaxherit, si dhe i aftëson ata të kryejnë analiza financiare, të vlerësojnë burimet njerëzore, të përgatitin planin marketing për biznesin e vogël.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimimin e mesëm. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në sipërmarrje dhe menaxhim të biznesit të vogël”; Modulin 2 “Sipërmarrja e biznesit të vogël”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	RM 1 Kursanti përshkruan funksionet dhe teknikat e menaxhimit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"> – të përshkruajë profesionin e menaxherit dhe aftësitë menaxheriale; – të përshkruajë hierarkinë menaxheriale; 	

- të përshkruajë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e menaxhimit në biznes;
- të përshkruajë menaxhimin si aktivitet universal;
- të përshkruajë aftësitë e nevojshme për menaxher të niveleve të ndryshme;
- të përshkruajë zhvillimin e profilit të menaxhimit;
- të shpjegojë procesin e menaxhimit dhe elementët e tij: planifikimi\organizimi\udhëheqja \kontrolli;
- të argumentojë nevojën e menaxherit për të planifikuar;
- të përshkruajë procesin e organizimit dhe zhvillimit të sipërmarrjes;
- të përshkruajë strukturën organizative funksionale të menaxhimit;
- të përshkruajë dinamikën e menaxhimit;
- të përshkruajë mjedisin e zhvillimit të sipërmarrjes në nivelin organizativ;
- të shpjegojë kuptimin e autoritetit menaxherial;
- të shpjegojë kuptimin e zotësisë në menaxhim
- të shpjegojë me anë të shembujve procesin e udhëheqjes dhe motivimit;
- të përshkruajë funksionimin e grupeve, etikën e sjelljes, rolin dhe statusin e grupeve.
- të përshkruajë llojet e komunikimit në biznes;
- të shpjegojë teoritë e motivimit në menaxhim;
- të shpjegojë procesin e kontrollit, rëndësinë dhe nevojën e kontrollit në sipërmarrje;
- të shpjegojë me anë të shembujve rëndësinë e procedurave të punës së menaxherit;
- të shpjegojë kuptimin e efikasitetit dhe efektivitetit si faktorë menaxherial;
- të përshkruajë problemet e menaxhimit që hasen gjatë delegimit të objektivave;
- të përshkruajë avantazhet dhe disavantazhet e menaxherit;
- të përshkruajë planet menaxheriale;
- të shpjegojë aftësitë konceptuale, teknike, aftësitë politike që disponon një menaxher;
- të shpjegojë prirjet dhe qëllimet e qarta manaxheriale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti përgatit planin marketing të biznesit të vogël.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë termin “marketing”, kuptimin e informacionit dhe kërkimit marketing;
- të argumentojë rëndësinë e përgatitjes së një plani marketing dhe komunikimit marketing;
- të përshkruajë buxhetin marketing;

- të përshkruajë dhe shpjegojë elementët e ndërtimit të një plani marketing;
- të përshkruajë strategjitë e marketingut: reklamat në media, shpërndarja e mostrave të vogla, promovimi në shëtitore me pakicë, të biznesit të vogël;
- të përshkruajë informata për tregun;
- të përshkruajë llojet e tregjeve;
- të përshkruajë segmentimin e tregut që i mundëson biznesi i tyre;
- të përshkruajë dimensionet që përdoren në segmentimin e tregut;
- të përshkruajë strategjitë dhe alternativat e tregut;
- të shpjegojë me anë të shembujve konkret analizën e tregut dhe analizën e konkurrencës;
- të përshkruajë 4P-t e marketingut;
- të shpjegojë rëndësinë dhe analizën e promovionit/ piarit\ promovimit;
- të kryejë me anë të shembujve konkret analizën e vendodhjes;
- të kryejë me anë të shembujve analizën e produktit;
- të përcaktojë faktorët që ndikojnë në caktimin e çmimit;
- të shpjegojë taktikat e krijimit të çmimit dhe strategjisë e cmimeve;
- të përgatisë ofertën totale të produktit (marka, paketimi, garancitë) ;
- të bëjë analizën e konsumatorit dhe të shpjegojë faktorët që ndikojnë në sjelljen blerëse, konsumatore;
- të kryejë analizën e riskut marketing për sipërmarrjen
- të përgatisë planin marketing;
- të llogarisë buxhetin marketing;
- të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe marrëdhëniet me konsumatorin;
- të përcaktojë mënyrat për kontrollin marketing;
- të përshkruajë marketingun online sipas rrjeteve sociale dhe teknologjisë së informacionit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti menaxhon burimet njerëzore të biznesit të vogël.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përkufizojë “burimet njerëzore”;
- të përshkruajë zhvillimin e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- të kryejë analizën e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm për burimet njerëzore;
- të bëjë analizën e rekrutimit të burimeve njerëzore;
- të bëjë rekrutimin nëpërmjet internetit;
- të bëjë rekrutim për diveristet;
- të bëjë rekrutim në kompaninë V;

- të bëjë rekrutim të jashtëm;
- të bëjë rekrutim të brendshëm;
- të bëjë intervista shqyrtuese për kandidaten/in e mundshëm;
- të bëjë teste selektuese;
- të përpilojë një kontratë të thjeshtë pune, me të drejtat e personelit të një biznesi të vogël;
- të bëjë analizën e punës dhe mbledhjes së informacionit për burimet njerëzore;
- të argumentojë rëndësinë e nevojës për burimet njerëzore;
- të përcaktojë teknikat e planifikimit të burimeve njerëzore dhe të bëjë planifikimin e tyre;
- të përshkruajë metodat e seleksionimit dhe rëndësia ekonomike e tyre, në zhvillimin dhe qendrueshmërinë e biznesit të vogël;
- të përcaktojë metodologjinë e duhur për vlerësimin e performancës së burimeve njerëzore;
- të bëjë vlerësimin e burimeve njerëzore sipas objektivave, kërkesës për vlerësuesit, gabimet e vlerësimit, vlerësimi 360 grade etj;
- të zhvillojë një intervistë vlerësimi, duke iu referuar rekomandimeve dhe letrës së referencës;
- të përshkruajë faktorët që ndikojnë në madhësinë e shpërblimit si dhe mekanizmat përcaktues të pagës;
- të llogarisë shpërblimin e pagës në lidhje me performancën në punë;
- të llogarisë përfitimet e punonjësve në punë, përfitimet sociale;
- të kryejë sistemin e të dhënave dhe informacionit për menaxhimin e burimeve njerëzore (bordero);
- të përshkruajë kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kryen veprime financiare të biznesit të vogël.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë analizën e përfitueshmërisë (profit) ;
- të analizojë rendimentin e mjeteve;
- të bëjë bilancin e gjendjes;
- të bëjë librin kryesor;
- të bëjë librin ndihmës;
- të planifikojë afatin mesatar të pagesës;
- të planifikojë qarkullimin e rezervave;
- të bëjë qarkullimin e mjeteve të përhershme;
- të bëjë qarkullimin e mjeteve të përgjithshme;
- të llogarisë borxhin ndaj mjeteve të përgjithshme;
- të llogarisë kamatat ndaj fitimit;
- të llogarisë shpenzimet e përgjithshme fikse ndaj fitimit;

- të bëjë llogaritë vjetore;
- të hartojë raportin e qarkullimit të inventarëve;
- të llogarisë në periudha mesatare arkëtimet;
- të planifikojë marzhin e fitimit, marzhin bruto e etj;
- të bëjë sigurimin e burimeve financiare;
- të bëjë një pasqyrë rrjedhëse të keshit;
- të bëjë pasqyrën e bilancit;
- të bëjë pasqyrën e të ardhurave;
- të bëjë regjistrimet parambyllëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e klasës dhe sipas mundësisë dhe në biznese /ndërmarrje të vogla.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me modele konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet ti jepen detyra të ndryshme në lidhje me menaxhimin dhe planifikimin financiar, të përgatitjes së informacioneve për promovimin e produkteve /shërbimeve, me përgatitjen e informacioneve për vlerësimin e burimeve njerëzore të një ndërmarrje të vogël.
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryen menaxheri dhe proceset e punës që bëjnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj) për konkretizimin e njohurive dhe aftësive.
 - Libra, broshura, fletëpalosje, katalogë
 - Modele të gatshme të planeve financiare, bilance, inventare, bordero, listë pagesa etj.
-

4. Moduli “Ndërtimi i një plan biznesi.”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	NDËRTIMI I NJË PLAN BIZNESI.	SMBV -04-20
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko- praktik që i njeh kursantët me konceptet bazë të ndërtimit të planit të biznesit, rolin dhe pjesët përbërëse të tij, si dhe i aftëson ata të ndërtojnë një plan biznesi real, bazuar në njohuritë dhe shprehjet që kanë fituar në modulet e sipërmarrjes dhe menaxhimit të biznesit të vogël.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimimin e mesëm. Të kenë përfunduar Moduli 1 “Hyrje në sipërmarrje dhe menaxhim të biznesit të vogël”; Modulin 2 “Sipërmarrja e biznesit të vogël”, Modulin 3 “Menaxhim i biznesit të vogël”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	RM 1 Kursanti përshkruan rëndësinë dhe përdorimin e planit të biznesit. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të shpjegojë kuptimin e një plani biznesi;– të argumentojë rëndësinë e përgatitjes së një plani biznesi nga ana e sipërmarrësit, për hapjen e një biznesi të ri apo zgjerimin e tij;– të përshkruajë vizionin, misionin dhe objektivat e planit të biznesit;– të përshkruajë avantazhet e hartimit të një plani biznesi;– të rendisin elementët kryesorë të një plani-biznesi;– të përshkruajë strukturat ligjore të planit të biznesit;– të përshkruajë proceset e menaxhimit në plani biznesi, si shitjet, financat, rekrutimi i personelit, zhvillimi i burimit të produktit, procedurat ligjore, administrata;– të përshkruajë të dhënat që do të shkruhen në pjesët përbërëse të planit të biznesit (formate të sugjeruara të gatshme të planeve të bizneseve) ;– të përshkruajë rëndësinë e analizës SËOT (përparësitë, dobësitë, mundësitë, rreziqet) për një biznes të vogël;– të përshkruajë analizën Brek - even për biznesin e vogël;– të përshkruajë analizën Pest për biznesin e vogël;– të përshkruajë karakteristikat e ofertës të produktit / shërbimit. <i>..Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje - përgjigje me gojë.– Pyetje - përgjigje me shkrim. RM 2 Kursanti ndërton planin e biznesit. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:	

- të shkruajë përmbledhjen ekzekutive të planit të biznesit: origjina e idesë, misioni, vizioni, objektivat fillestare, statuti ligjor etj;
- të shkruajë parashikimet financiare\kostot e fillimit të një biznesi të vogël;
- të bëjë përshkrimin e produktit/shërbimit;
- të përgatisë të dhëna për ciklin e produktit;
- të përgatisë të dhëna për vendodhjen e biznesit;
- të përgatisë planin e marketingut për produktin / shërbimin;
- të shpjegojë metodat që propozohen për të siguruar prodhime me cilësi, si kontrollin e inventarit si dhe sigurimin e lëndëve të para;
- të bëjë llogaritjen e investimeve dhe pajisje prodhimi;
- të bëjë raportet e të ardhurave dhe shpenzimeve për një periudhë kohe të caktuar (5-vjeçare) dhe parashikimi i rrjedhës së parasë;
- të kryejë indeksin e detajuar të përmbajtjes së planit të biznesit;
- të hartojë strategji si faktor kyç të suksesit të biznesit të vogël;
- të hartojë strategji të planit të shitjes të biznesit të vogël.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit.

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e klasës dhe sipas mundësisë dhe në biznese të vogla ose sipërmarrje të vogla
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me modele të gatshme .
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet ti jepen detyra të ndryshme në lidhje me çështjet që trajtohen në modul, me ndërtimin e planit të biznesit dhe elementët përbërës të tij, me analizën SWOT, Brek- even, Pests, me përgatitjen e raporteve financiare, si dhe rëndësinë që ka përgatitja e një plani biznesi për vlerësimin dhe zhvillimin e biznesit të vogël.
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.

-
- Medie didaktike (CD, filma, etj) për konkretizimin e njohurive dhe aftësive.
 - Libra, broshura, fletëpalosje, katalogë
 - Modele te gatshme te planeve te biznesit, modele bilancesh, modele të pasqyrave financiare, modele inventaresh, modele analize SWOT etj.
-